



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:047909

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05407747

C.nr.763/24

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Agron Karatash, me zyrtaren ligjore Imihane Ramadani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.A., nga Prizreni, rr. “.....”, p.nr., kundër të paditurës J.A., nga Prizreni, rr. “Besim Shala”, p.nr., të cilën me autorizim e përfaqëson av. B.P., nga Prizreni, për shkak të ndryshimit të aktgjykimit, me datën **04.03.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se padia e paditësit E.A., nga Prizreni, kundër të paditurës J.A., nga Prizreni, për shkak të ndryshimit të aktgjykimit C.nr.533/18 të datës 16.07.2018, në këtë çështje juridike kontestimore **është e tërhequr**.

A r s y e t i m

Pranë kësaj gjykate, paditësi E.A., nga Prizreni, me datë 12.02.2024, ka parashtruar padi kundër të paditurës JA., nga Prizreni, me objekt të padisë ndryshimin e aktgjykimit C.nr.533/18 të datës 16.07.2018.

I autorizuari i paditëses, përmes parashtresës së datës 21.02.2024, ka njoftuar gjykatën se për shkak se palët ndërgjyqës kanë arritur marrëveshje lidhur me këtë çështje kontestimore bëjnë tërheqjen e padisë sepse të njëjtit dëshirojnë që të ngelet në fuqi aktgjykimi C.nr.533/18 i datës 16.07.2018.

Si rrjedhojë, bazuar në nenin 261 pika 1 dhe 3 të Ligjit të procedurës kontestimore, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për të konstatuar se paditësit e kanë tërhequr padinë e parashtruar.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2024:047909, **04.03.2024**

Gjyqtari
Agron Karatash

UDHËZIM JURIDIK: Duke u bazuar në nenin 261 paragrafi 4 të LPK-së, kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.